



Pranuar / Dorezuar Prijemeno/Prodato Received/Delivered	14.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPD/SHK/1	7083/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.906/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, më Ilire Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.906/2022 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ nga Prishtina, me adresë banimi _____ kundër Vendimit me numër protokoli 1371/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "Transferim në rast ristrukturimi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.906/2022 të datës 13.10.2022, të parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 13.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6146/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 1371/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me transferimin e saj në pozitën e punës "Drejtor i Arkivit Ndërkomunal" në Agjencinë Shtetërore e Arkivave të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 21.10.2022 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik. Ndërsa Këshilli me datë 31.10.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6146/2022 të datës 13.10.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit me numër 01/326/22 të datës 07.10.2022; Vendimin me numër të protokollit 1371/2022 të datës 15.09.2022 për transferimin e nëpunëses civile për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, Letrën sqaruese (pa numër dhe datë); E-mailin e datës 05.04.2022 të drejtuar Shkresën e datës 06.04.2022; CV e ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.10.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 31.10.2022; Vendimin me numër A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Fletë kthesat e datës 17.10.2022 të pranuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (gjithsej pesë flete kthesa); Flete kthesën e datës 21.10.2022 me të cilën dëshmohet se ankuesja ka pranuar vendimin e KPSHCKS-së;

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar shkresat ndërlidhur me këtë çështje juridike-administrative, ka konstatuar që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën e ankuesit A.nr.906/2022 të datës 13.10.2022, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja sipas Akt-it të Emërimit me numër protokollit 79 të datës 01.02.2019 ka qenë e emëruar në pozitën e punës Drejtoreshë në Departamentin për Hulumtime dhe Përkrahjen e Investime të Diasporës në ish Ministrinë e Diasporës, e cila pozitë nuk është e paraparë me Rregulloren Nr. 01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe pasi që e njëjta nuk plotëson kriteret e posaçme formale për asnjë pozitë punë të lirë në MPJD, Komisioni për Ristrukturim ka propozuar që e njëjta të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesja me datë 10.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër shpalljes së datës 20.07.2022 të konkurseve për pozitat e Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve në MPJD. Këshilli gjatë vendosjes së ankesës së ankuesit të datës 10.08.2022 ka pranuar si provë shtesë edhe Vendimin me numër Nr.141/2022 dhe numër protokollit 1371 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me sistemimin e ankueses në pozitën Drejtor i Arkivit Ndërkomunal në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022 ka shfuqizuar Vendimin Nr.141/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke e obliguar Komisionin e Ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të rishqyrtoj rastin e sistemimit të ankueses.

Andaj nisur nga gjendja faktike si më lartë, dhe duke qenë se objekti i ankesës A.nr.906/2022 të datës 13.10.2022 i referohet vendimit i cili është shfuqizuar nga Këshilli me Vendimin A.nr.723/2022 të datës 05.10.2022, Kolegji mbi bazën e këtyre rrethanave vlerëson se objekti i ankesës respektivisht qëllimi i ankesës së ankueses me numër A.nr.906/2022 të datës 13.10.2022 është bërë i pamundur -

kotë, kështu që, në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos që të përfundohet procedura administrative e iniciuar sipas ankesës së ankueses me numër A.nr.905/2022 të datës 13.10.2022.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.906/2022

Ilire Shaqiri MEHMETI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.